



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 156, Datë 31.07.2024

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ACHELO” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“KOTORRI”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1534/9prot., datë 30.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ACHELO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534 prot., datë 20.06.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Kotorri” me kapacitet prodhues 1.9 MW, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 02.07.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 03.07.2024 dhe 04.07.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.07.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE me shkresën me nr. 1534/4 prot., datë 05.07.2024, i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe njoftimin për zhvillimin e një seance dëgjimore në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1534/5 prot., datë 18.07.2024 dhe nr.1534/7 prot., datë 23.07.2024 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se nga ana e shoqërisë duhet të plotësohet dhe sa vijon:
- Shoqëria disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie” e cila është aktualisht e vlefshme, por duke qenë se afati i saj nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ashtu si në rastet analoge, duhet të depozitohet në ERE leja e rinovuar brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 18.09.2025.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentralit, në seancën dëgjimore të datës 15.07.2024 shoqëria ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet, ajo është pajisur me vendimin Këshillit Kombëtar të Territorit më datë 05.07.2024, por nuk është zbardhur leja e ndërtimit. Në të tilla rrethana, vlerësohet që të dokumentohet në ERE data e fillimit të punimeve por jo më vonë se data 14.09.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).
- Në kuptim të nenit 9, pikës 1.3, gërmave “b” dhe “c”, Shoqëria ka depozituar në ERE analizën ekonomike dhe financiare, Planin e Biznesit ku është bërë një përshkrim i të dhënave të përgjithshme të projektit për ndërtimin e Hec “Kotorri” nga shoqëria “ACHELO” sh.p.k., si dhe është paraqitur preventivi i detajuar në formë tabelare. Për sa i përket mënyrës së financimit, shoqëria ka ndryshuar formën e financimit, ku shoqëria do ta financojë 100% me fondet e ortakëve. Gjithashtu shoqëria “ACHELO” sh.p.k. do ta kthejë huanë për një periudhë 10 vjeçare nga të ardhurat që do sigurojë nga shitja e energjisë. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues që ortakët e saj e disponojnë shumën që do të vendoset në dispozicion për ndërtimin e veprës; dokumentacion vërtetues mbi saktësimin e modalitetit të ri të financimit.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Për gjithë sa më sipër, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Kotorri, me kapacitet të instaluar 1.9MW.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ACHELO” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI